

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 1924 Prot

Durrës, më 25.08.2025

V E N D I M

Nr. 88, datë 25.082025

PËR

"OFRIMIN EDHE NË GJUHËN ANGLEZE TË PROGRAMIT TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, BACHELOR, NË "MENAXHIM TURIZËM" ME PROFIL "MENAXHIM HOTEL RESTORANT", NË FAKULTETIN E BIZNESIT, TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës"

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; të VKM-së Nr. 41 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga insitucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar me VKM Nr.879, datë 16.12.2019 për "Disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga insitucionet e arsimit të lartë"; të Udhëzimit Nr. 01, datë 14.01.2020, për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e insitucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisë kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e insitucionit të arsimit të lartë" i ndryshuar; të Statutit dhe të Rregullores së UAMD-së, si dhe bazuar në shkresën me Nr. 1832/1 Prot., datë 25.08.2025 të Drejtorisë së Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ofrimit edhe në gjuhën angleze të programit të ciklit të parë të studimeve, Bachelor, në "Menaxhim Turizëm" me profil "Menaxhim Hotel Restorant", me 180 kredite, pranë Departamentit të Turizmit, në Fakultetin e Biznesit, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës".
2. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratimin e tarifës përkatëse.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - ✓ Zv. Rektorët
 - ✓ Drejtuesi i Njesisë Kryesore të Fakultetit të Biznesit
 - ✓ Drejtuesi i Njesisë Bazë i Departamentit të Turizmit
 - ✓ Drejtorja e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI

